



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 7, datë 31.01.2022**

**MBI  
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË  
SHOQËRISË “BANKA E TIRANËS” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21 dhe nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E :**

Shoqëria “Banka e Tiranës” sh.a., disponon licencën nr. 1, datë 21.05.2010 (pa afat) si “*Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë së RSH në bursë dhe në tregun me pakicë*”, licencë e cila është lëshuar në bazë të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, i shfuqizuar. Licenca si shoqëri brokerimi (broker-dealer) nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara është e njëjtë me shërbimet e investimit: Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit, ekzekutim urdhërash dhe tregtim për llogari të vet, të përcaktuara në Ligjin e ri 62/2020.

Shoqëria “Banka e Tiranës” sh.a., mban gjithashtu licencën nr. 1, datë 21.05.2010 (pa afat) për të vepruar si “*Kujdestar i titujve të Qeverisë së RSH*”. Sipas Ligjit të ri nr. 62/2020, shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, konsiderohet shërbim ndihmës.

“Banka e Tiranës” sh.a., ka paraqitur raportin e përshtatshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores së AMF-së nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, si dhe ka depozituar kërkesën për zgjerimin e licencës me qëllim zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare që do t’i ofrojë

klientëve. Më konkretisht, shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare që do ofrohen nga “Banka e Tiranës” sh.a., janë:

1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare;
2. Ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve;
3. Tregtimi për llogari të vet.

Shërbimet ndihmëse:

Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

Instrumentet financiare:

1. Titujt e transferueshëm;
2. Instrumentet e tregut të parasë.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

### **V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka e Tiranës” sh.a. me kërkesat e Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij në:**

**A. Ofrimin e shërbimeve të investimit në titujt e Qeverisë si:**

- a) Marrje dhe transmetim i urdhrave;
- b) Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve;
- c) Tregtim për llogari të vet.

**B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në titujt e Qeverisë si:**

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

- 2. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Banka e Tiranës” për:**

**A. Instrumentet financiare si më poshtë:**

1. Titujt e transferueshëm;
2. Instrumentet e tregut të parasë.

**B. Ofrimin e shërbimit ndihmës “Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve”, për të gjitha instrumentet financiare të listuar më sipër.**

- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**